



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO		
KOMUNA E PODUJEVËS - OPŠTINA PODUJEVO - MUNICIPALITY OF PODUJEVA		
DREJTORIA E ADMINISTRATËS - UPRAVA ADMINISTRACIJE		
Deqitur në Postështet	15.12.2022.	
Org. Org. Sed.	No. Nr.	Shtypje - Prilog
02-300/61-010212/22		
PODUJEVË - PODUJEVO		



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës Opština Podujevo Municipality of Podujeva

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT EKONOMIK

RAPORTI PUNËS (Janar – Dhjetor, 2022)

- Në bashkëpunim me MZHR-në dhe AZHR-Qendër, është organizuar Sesion Informues për thirrjen e lansuar “Programi për Zhvillim të Balancuar 2022” për Bizneset dhe Start-up.
- Në koordinim me BSCK si rezultat i Memorandum bashkëpunimit të lidhur me projektin: “Aftësi dhe Shkathtësi të buta për Ndërmarrësi dhe Marketing Digjital”, është realizuar projekti, përkatësisht blerja e pajisjeve dhe implementimi te përfituesit, kemi 14 përfitues të ndarë në sektorë të ndryshëm si: Gastronomi, Autolarje, Zdrukthëtari, Rrobaqepësi, Berber etj.
- Është realizuar “Analiza e Fizibilitetit e Parkingut nëntokësor” dhe dokumentacionet e tjera të nevojshme për projektin që do të zhvillohet me partneritet publiko-privat të Parkingut nëntokësor.
- Në koordinim me Organizatën HELP si rezultat i Memorandum bashkëpunimit të lidhur me projektin: “Women in Energy Entrepreneurs”, është realizuar projekti, përkatësisht shpërndarja e pajisjeve te përfituesit, kemi 22 përfitues të ndarë në sektorë të ndryshëm si: Gastronomi, Rrobaqepësi, Dizajn dhe Prodhime tekstili.
- Është arritur Memorandum bashkëpunimi me EcoKosWoman për projektin “Fuqizimi ekonomik i grave në viset rurale, krijimi i vendeve të punës dhe prosperiteti më i mirë përmes angazhimit në bujqësi”, është realizuar projekti, përkatësisht shpërndarja dhe montimi i nëntë (9) serrave me sipërfaqe 100m², janë organizuar trajnime dhe do të organizohet panairi me produktet apo prodhimet e të mbjellurave.
- Në bashkëpunim me NGO Lady është realizuar panairi i artizanaleve të punuara nga gratë llapjane “Kujtime nga atdheu”.

- Është realizuar projekti, festivali veror “Ditët e Diasporës” janë dhënë në shfrytëzim shtëpizat e drurit në sheshin “Ali Ajeti”, përkatësisht janë mbështetur biznese të gastronomisë dhe të prodhimit, përpunimit të prodhimeve bujqësore, artizanate dhe të natyrës së ngjajshme.
- Është inicuar procedura për themelimin e Ndërrmarrjes Publike Lokale (NPL) në Komunën e Podujevës, me qëllim të ofrimit të shërbimeve publike më cilësore dhe me kosto më të ulët.
- Është mbajtur punëtori e përbashkët me Biznese të Komunës së Podujevës, ku është diskutuar për tri (3) projektet kryesore të Komunës:
 - Zonën Ekonomike - Industriale,
 - Parkingun Nëntokësor dhe
 - Subvencionimin e interesit të kredive për biznese prodhuese,
 Pjesë e takimit ishte Kryetari i Komunës, Shpejtim Bulliqi dhe Ministri e MINT, Rozeta Hajdari.
- Është realizuar projekti “Botime dhe publikime”, përkatësisht Katalogu i parcelave apo pronave për dhënje në shfrytëzim si dhe platforma elektronike në web-in e Komunës.
- Në thirrjen e MZHR-së për Investime Kapitale për vitin 2022 “Programi për Zhvillim Rajonal” janë identifikuar, hartuar dhe kompletuar dy (2) projekte ide me të cilat kemi aplikuar:
 - ✓ *Ndërtimi i Stacionit të Autobusëve - Faza e parë. (i përfituar)*
 - ✓ *Kërkesa për vazhdimin e projektit të vitit 2021- Ndërtimi i urave në fshatrat Sfeqël, Bajqinë dhe Gllamnik. (i përfituar)*
- Në thirrjen e MAPL-së me UN-Habitat dhe MPHI-së “Programi-Instrumenti i investimeve Publike IIK -CIF”, janë identifikuar, hartuar dhe kompletuar dy (2) projekte ide me të cilat kemi aplikuar:
 - Në Lot 1 (vetëm si Komunë):
 - ✓ *“Podujeva për Eficiencë dhe Zhvillim Efikas” (i përfituar)*
 - ✓ *“Ndërtimi i Kolektorit të ujërave të zeza përgjate lumit Batllava nga fshati Gërdoc deri në fshatin Luzhan”.*
 - Në Lot 2 (bashkë me OJQ):
 - ✓ *“Podujeva riciklon” në partneritet me OJQ Ekovisioni.*

- Në thirrjen e MZHR-së për Investime Kapitale për vitin 2023, janë identifikuar, hartuar dhe kompletuar dy (2) projekt ide me të cilat kemi aplikuar:
 - ✓ Ndërtimi i tri (3) fushave sportive në SHFMU “Zahir Pajaziti” në Orllan (*në pritje?*)
 - ✓ Ndërtimi i shtigjeve për ecje në zonat: Shakovicë – Bellopojë dhe Pakashticë e Poshtme – Zakut. (*në pritje?*)
- Është hartuar Rregullorja e re për orarin e punës së bizneseve që operojnë në territorin e Komunës së Podujevës dhe është miratuar në Kuvendin Komunal .
- Është nënshkruar kontratë me Agjensionin Pyjor të Kosovës për marrjen në shfrytëzim të tokës pyjore nga Komuna e Podujevës, përkatësisht “Pishat e Kërpimehit” dhe “Pishat e Shakovicës”, pasi që në vitin e ardhshëm në sektorin e Turizmit planifikohet të investohet në këto hapësira, ku do të ndërtohen shtigje për ecje, vendosen pushimore dhe shporta të mbeturinave.
- Është realizuar Projekti “Investimi në Infrastrukturën e Turizmit”, përkatësisht rregullimi i Parkut të Paqës dhe Parkut të Manchesterit, ndërtimi i kinemasë së hapur, vendosja e këndeve të lojrave dhe hapsirave tjera për rekreacion.
- Është në fazën përfundimtare realizimi i projektit “Analiza e Fizibilitetit e Zonës Industriale” dhe dokumentacionet e tjera të nevojshme për ngritjen e Zonës Ekonomike – Parkut Industrial dhe njëkohësisht themelimi i saj, ku janë zhvilluar të gjitha procedurat ligjore për shpronësim me AKP-në.
- Është arritur Memorandum bashkëpunimi me EcoKosWoman për projektin “Gruaja dhe mbrojtja e ambientit përmes aktiviteteve bujqësore”, përmes këtij projekti do të mbështesim mbjelljen e sipërfaqeve me bimë mjaltëdhënëse, me qëllim të rritjes së prodhimtarisë së mjaltës, përkatësisht arritjen e rendimenteve të kënaqshme për bletarët tanë.
- Në koordinim me përfaqësues të barnatorëve është rregulluar orari i kujdestarive për vitin 2023 për:
 - Festa Zyrtare
 - Të dielave
 - Gjatë Natës
- Është realizuar Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal 2023 – 2025 dhe është miratuar në Kuvendin Komunal.

- Është realizuar Katalogu promovues në gjuhën Gjermane “Exportstandort Podujeva” me fokus të veçantë për Zonën Industriale dhe platforma elektronike në web-in e Komunës.
- Është në realizim projekti/festivali dimëror “Ditët e fundvitit”, janë vendosur shtëpizat nga druri në sheshin “Sheshi i Dëshmorëve”, dhe është publikuar thirrja për aplikim për dhënie në shfrytëzim të këtyre shtëpizave.
- Sektori i regjistrimit të Bizneseve ka realizuar këto punë dhe aktivitete :

Nr.	Aktiviteti	Nr. i lëndëve
1.	Regjistrime të bizneseve	315
2.	Shuarje të bizneseve	35
3.	Ndryshime në bizneset ekzistuese	153
4.	Certifikata të reja (me nr.unik identifikues)	124
5.	Informata	165
	TOTALI	793

(Të dhënat e paraqitura në tabelë, janë prej 01.01.2022 deri më dt.13.12.2022)

- Janë ofruar këshilla dhe asistencë për bizneset, të rinjtë dhe qytetarët për fushën dhe kompetencën që ne mbulojmë.
- Janë mbajtur Takime dhe Punëtori të ndryshme me:
 - Kosovo Local Government - Instituti Kosovar për Qeverisje Lokale
 - MAPL – UN-Habitat – MMPH
 - AZHR – MZHR
 - MINT
 - WWFF Adria dhe MMPHI
 - Asociacioni i Komunave të Kosovës
- Të tjera...

15.12.2022

Drejtor i DPZHE:
z. Vigan Salihu

